

VENDIM
Nr. 593, datë 18.10.2023

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E KOMITETIT TË POLITIKAVE TË MENAXHIMIT TË HAPËSIRËS AJRORE SHQIPTARE DHE RREGULLAT PËR KOORDINIMIN E BASHKËPUNIMIN PËR ORGANIZIMIN E HAPËSIRËS AJRORE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë e të ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Ky projektvendim ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së organizimit, funksionimit dhe detyrave të Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare dhe rregullave për koordinimin e bashkëpunimin për organizimin e hapësirës ajrore.

2. Ky vendim përforcon dhe harmonizon zbatimin e konceptit për përdorimin fleksibël të hapësirës ajrore, si në Qiellin e Vetëm Evropian, me qëllim lehtësimin e menaxhimit të hapësirës ajrore dhe menaxhimit të trafikut ajror brenda kufijve të politikave të transportit dhe në veçanti përcakton rregulla për bashkëpunim më të mirë ndërmjet strukturave civile dhe ushtarake përgjegjëse për menaxhimin e trafikut ajror, që operohet në hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

Për zbatimin e këtyre rregullave përdoren përkufizimet e Kodit Ajror dhe ato të përshkruara në këtë nen, si më poshtë vijon:

1. “Autoriteti i Aviacionit Civil”, enti publik në varësi të ministrit përgjegjës për transportin, i cili ushtron funksionet e autoritetit kombëtar për rregullimin e mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror, në përputhje me Kodin Ajror dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tij dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare;

2. “Certifikatë”, një dokument i lëshuar nga autoriteti kombëtar mbikëqyrës në çdo formë që përputhet me rregullat kombëtare, e cila konfirmon se një ofrues i shërbimit të lundrimit ajror i plotëson kërkesat për ofrimin e një shërbimi specifik;

3. “Celula për menaxhimin e hapësirës ajrore (AMC)”, njësi përgjegjëse për menaxhimin e përditshëm të hapësirës ajrore nën përgjegjësinë e Republikës së Shqipërisë ose të më shumë shteteve të ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe;

4. “Celula kombëtare e krizave për menaxhimin e trafikut ajror”, Komiteti i Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare gjatë ushtrimit të funksioneve të përcaktuara në nenin 9, të këtij vendimi;

5. “Hapësirë ajrore ndërkufitare”, strukturë e hapësirës ajrore e zgjatur përgjatë kufijve kombëtarë dhe/ose kufijve të rajoneve të informacionit të fluturimit;

¹ Ky vendim është përafëruar plotësisht me parashikimet e rregullores (EC) nr. 2150/2005, datë 23 dhjetor 2005, mbi rregullat e përgjithshme për përdorimin fleksibël të hapësirës ajrore dhe pjesërisht me rregulloren nr. 549/2004, “Mbi krijimin e strukturës së Qiellit të Vetëm Evropian (kuadri rregullator)”, të ndryshuar.

6. "Itinerari/*routing*", itinerari i zgjedhur, që ndiqet nga një avion gjatë veprimit/operacionit të tij;
7. "Koncepti i operimit", kriteri për përdorimin operacional të RREMTA-s ose të pjesëve të saj;
8. "Kohë reale", kohë aktuale gjatë së cilës ndodh një proces ose një ngjarje;
9. "Koordinim civil-ushtarak", koordinim ndërmjet palëve civile dhe ushtarake të autorizuara për të marrë vendime e për të dakordësuar për një drejtim veprimesh;
10. "Komanda e Forcave Ajrore", autoriteti kompetent ushtarak, pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që ka mision sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për vëzhgimin dhe kontrollin e sovranitetit të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me NATO-n, mbështetjen në operacionet luftarake e joluftarake, HNS dhe ato të kërkim-shpëtimit SAR, si dhe realizimin e komandim-kontrollit të mjeteve ajrore në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë;
11. "Korridor fluturimi", rruga e një avionit në ajër, e përcaktuar në tri dimensione;
12. "Kufizim i hapësirës ajrore", një vëllim i caktuar i hapësirës ajrore brenda së cilës mund të kryhen, në orë të përcaktuara, aktivitete të ndryshme të rrezikshme për fluturimin e avionëve (një "zonë e rrezikshme"); ose hapësira të tilla ajrore të caktuara mbi sipërfaqe toke apo ujërash territoriale të një shteti, brenda të cilave fluturimi i avionëve është i kufizuar sipas kushteve specifike të caktuara (një "zonë e kufizuar"); ose hapësira të tilla ajrore të caktuara mbi sipërfaqe toke apo ujërash territoriale të një shteti, brenda të cilave fluturimi i avionëve është i ndaluar (një "zonë e ndaluar");
13. "Menaxhimi i hapësirës ajrore (MHA)", një funksion planifikimi me objektiv kryesor maksimizimin e shfrytëzimit të hapësirës ajrore në dispozicion nëpërmjet ndarjes dinamike të kohës dhe herë-herë ndarjen e hapësirës ajrore mes kategorive të ndryshme të përdoruesve të hapësirës ajrore mbi bazën e nevojave afatshkurtra;
14. "Menaxhimi i fluksit të trafikut ajror", funksion i vendosur me objektivin për të kontribuar për një fluks të sigurt, të rregullt e të shpejtë të trafikut ajror, duke siguruar që kapaciteti i KTA-së shfrytëzohet deri në maksimumin e mundshëm dhe se volumi i trafikut është i përshtatshëm me kapacitetet e deklaruara nga sigurvearit e duhur të shërbimit të trafikut ajror;
15. "Menaxhimi i trafikut ajror (ATM)", tërësia e funksioneve ajrore dhe tokësore (shërbimet e trafikut ajror, menaxhimi i hapësirës ajrore dhe menaxhimi i fluksit të trafikut ajror) të nevojshme për të siguruar lëvizjen e sigurt dhe efikase të avionit gjatë të gjitha fazave të operimeve;
16. "Masterplani i MTA-së", plani i mbështetur në vendimin e Këshillit Evropian për rregullat evropiane për krijimin e një sipërmarrjeje të përbashkët, për të zhvilluar një gjeneratë të re të sistemit evropian të menaxhimit të trafikut ajror (SESAR);
17. "Niveli i fluturimit (NF)", sipërfaqe e presionit atmosferik konstant, i cili lidhet me karakteristikat e presionit specifik prej 1 013,2 hektopaskal dhe ndahet nga të tilla sipërfaqe të tjera me intervale presioni specifik;
18. "Ngjitja/përmirësimi", çdo modifikim, që ndryshon karakteristikat operationale të një sistemi;
19. "Njësi e shërbimeve të trafikut ajror" (njësi ATS), njësi, civile ose ushtarake, përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror;
20. "Ndarje", hapësira midis avionëve, niveleve ose gjurmëve;
21. "Njësi ushtarake kontrolli", çdo njësi fikse apo e lëvizshme ushtarake, që drejton trafikun ajror ushtarak dhe/ose ndjek aktivitete të tjera, të cilat, për shkak të natyrës së tyre specifike, mund të kërkojnë një rezervim apo kufizim të hapësirës ajrore;
22. "Operacioni/veprimi perfekt në mënyrë konsistente", veprimi i RREMTA-s, në mënyrë të tillë që nga perspektiva e përdoruesit ai të veprojë sikur të ishte një organ i vetëm;
23. "Paketa e shërbimeve", dy ose më shumë shërbime të lundrimit ajror;

24. “Përbërësit”, objektet e prekshme, si *hardware* apo objektet e paprekshme, si *software* mbi të cilat varet ndërveprimi i RREMTA-s;

25. “Përdorim fleksibël i hapësirës ajrore”, koncept i menaxhimit të hapësirës ajrore i zbatuar në hapësirën e Republikës së Shqipërisë dhe atë të ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, mbi bazën e “Manualit të menaxhimit të hapësirës ajrore për zbatimin e konceptit të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore” të nxjerrë nga Eurokontrolli;

26. “Procedura” (siç përdoret në kontekstin e udhëzimit të ndërveprimit), një metodë standarde dhe për përdorimin teknik, dhe për atë operacional të sistemit, në kontekstin e koncepteve të funksionit të rëna dakord e të vlerësuara, që kërkojnë zbatim uniform nëpërmjet RREMTA-s;

27. “Përdorues të hapësirës ajrore”, operatorë të avionëve që operohen si trafik i përgjithshëm;

28. “Përdorues”, mjet ajror civil ose ushtarak, që operon në ajër, si edhe çdo palë tjetër që kërkon përdorimin e hapësirës ajrore;

29. “Qëllimi i fluturimit”, korridor i fluturimit dhe të dhënat shoqëruese të fluturimit, që përshkruajnë trajektoren e planifikuar të një fluturimi drejt destinacionit të tij, i përditësueshëm në çdo moment;

30. “Qielli i Vetëm Evropian”, iniciativë e Komisionit Evropian, e cila koordinon projektimin, menaxhimin dhe rregullimin e hapësirës ajrore brenda ZPAE-së, me qëllim organizimin e hapësirës ajrore uniforme me zonat e kontrollit të trafikut ajror, duke siguruar përdorimin e sigurt dhe efikas të hapësirës ajrore dhe sistemin e menaxhimit të trafikut ajror brenda dhe përtej Bashkimit Evropian;

31. “Rezervim i hapësirës ajrore”, vëllim i caktuar i hapësirës ajrore i rezervuar përkohësisht për përdorim ekskluziv ose specifik nga kategoritë e përdoruesve;

32. “Rajoni i informacionit të fluturimit”, hapësirë ajrore e dimensioneve të përcaktuara, brenda së cilës jepen shërbimet e informacionit të fluturimit dhe shërbimet e paralajmërimit/njoftimit;

33. “Rrjeti i linjës/rrugës”, rrjet linjash të specifikuara për kanalizimin e fluksit të trafikut ajror të përgjithshëm, siç është e nevojshme për shërbimet e dispozitës/pajisjes së KTA-së;

34. “Rrjeti evropian i menaxhimit të trafikut ajror (RREMTA)”, grupi i listuar i sistemeve të mëposhtme:

a) Sisteme dhe procedura për menaxhimin e hapësirës ajrore;

b) Sisteme dhe procedura për menaxhimin e fluksit të trafikut ajror;

c) Sisteme dhe procedura për shërbimet e trafikut ajror, në veçanti për sistemet e përpunimit të të dhënave të fluturimeve, përpunimi i të dhënave të vëzhgimit dhe sistemet e ndërfaqes njeri–makineri;

ç) Sistemet e komunikimit dhe procedurat tokë–tokë, ajër–tokë dhe ajër–ajër të komunikimeve;

d) Sistemet dhe procedurat e navigimit;

dh) Sistemet dhe procedurat e vëzhgimit;

e) Sistemet dhe procedurat për shërbimet e informacionit aeronautik;

ë) Sistemet dhe procedurat për përdorimin e informacionit meteorologjik, i cili mundëson që shërbimet e lundrimit ajror të sigurohen në komunitet, duke përfshirë ndërfaqet në kufij me shtetet e treta.

35. “Sistem”, mbledhja e përbërësve të transportit me rrugë ajrore dhe të atij me bazë tokësore, si dhe një pajisje me bazë hapësinore, që jep mbështetje për shërbimet e lundrimit ajror për të gjitha fazat e fluturimit;

36. “Strukturë e hapësirës ajrore”, vëllim i caktuar i hapësirës ajrore i përcaktuar për të garantuar operacionin e sigurt dhe optimal të avionit;

37. “Situata e krizës”, spektri i gjerë i krizave të mundshme, duke filluar nga trazira të kufizuara kombëtare ose rajonale, ose operimet e ndihmave humanitare deri në operimet si

përgjigje ndaj një krize të një shkalle të gjerë kombëtare, ose që përfshin forcat aleate të NATO-s, me përfaqësim të mundshëm të partnerëve, dialogut mesdhetar dhe shteteve të tjera joanëtare të NATO-s;

38. “Shërbimet e kontrollit të trafikut ajror (KTA)” përfshijnë shërbimet e ofruara me qëllim që:

a) të parandalohen përplasjet:

i. mes avionëve;

ii. në zonën e manovrimit mes avionit e pengesave; dhe

b) të ecë e të mbahet një fluks i rregullt i trafikut ajror.

39. “Shërbimi i kontrollit të aerodromit” përfshin shërbimin e KTA-së për trafikun në aerodrom;

40. “Shërbimi i informacionit aeronautik (SHIA)”, shërbim i vendosur brenda zonës së përcaktuar të mbulimit, përgjegjës për pajisjen e informacionit aeronautik dhe i të dhënave të nevojshme për sigurinë, rregullsinë dhe efikasitetin e lundrimit ajror;

41. “Shërbime të trafikut ajror”, shërbime të ndryshme të informacionit të fluturimit, shërbimet e alarmit, shërbimet këshilluese të trafikut ajror dhe shërbimet ATC (shërbimet e kontrollit të zonës, afrimit dhe aerodromit);

42. “Shërbimet e kontrollit të zonës”, shërbim KTA për fluturimet e kontrolluara në një bllok hapësire ajrore;

43. “Shërbimi i paralajmërimit”, një shërbim i ofruar për të njoftuar organizatat përkatëse apo operatorët ajrorë lidhur me një mjet fluturimi në nevojë për ndihmë kërkimi e shpëtimi dhe për të ndihmuar këto organizata sipas nevojës;

44. “Shërbime ndërkuftare”, çdo rrethanë, ku shërbimet e lundrimit ajror ofrohen në një shtet nga një ofruer shërbimi i certifikuar në një shtet tjetër ose shtet anëtar, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe;

45. “Trafiku ajror i përgjithshëm”, të gjitha lëvizjet e avionëve civilë, si dhe të gjitha lëvizjet e avionëve shtetërorë (duke përfshirë avionët e policisë dhe doganës), kur këto lëvizje bëhen në përputhje me rregullat e vendimet e ICAO-së.

46. “Të dhënat operationale”, informacioni lidhur me të gjitha fazat e fluturimit, që kërkohen për të marrë vendime operationale nga siguruesit e shërbimit të lundrimit ajror, përdoruesit e hapësirës ajrore, operatorët e aeroportit dhe veprues të tjerë të përfshirë;

47. “Vënia në punë”, përdorimi i parë operacional pas instalimit fillestar ose ngritjes së një sistemi.

Neni 3 Parimet

Përdorimi fleksibël i hapësirës ajrore bazohet në parimet e mëposhtme:

a) Koordinimi ndërmjet autoriteteve civile dhe ushtarake, i organizuar në nivele strategjike, parataktike dhe taktike, për të mundësuar përdorimin fleksibël të hapësirës ajrore nëpërmjet vendosjes së marrëveshjeve dhe procedurave për rritjen e sigurisë në operim e të kapacitetit të hapësirës ajrore dhe përmirësimit të eficiencës e fleksibilitetit të operationeve të avionëve;

b) Vendosja dhe ruajtja e qëndrueshmërisë midis menaxhimit të hapësirës ajrore, menaxhimit të lëvizjes së trafikut ajror dhe shërbimeve të trafikut ajror, në të tria nivelet e menaxhimit të hapësirës ajrore të renditura në shkronjën “a”, të këtij neni, për të garantuar, në përfitim të të gjithë përdoruesve, eficiencën në planifikimin, shpërndarjen dhe përdorimin e hapësirës ajrore;

c) Rezervimi i një natyre të përkohshme i hapësirës ajrore për përdorim ekskluziv ose specifik për kategoritë e përdoruesve, e aplikuar vetëm gjatë periudhave të limituara kohore, bazuar mbi përdorimin aktual dhe lëshuar sa më shpejt, sapo aktiviteti i kryer në këtë hapësirë të ketë mbaruar;

ç) Bashkëpunimi për aplikimin eficient dhe të qëndrueshëm të konceptit të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore përgjatë kufijve kombëtarë dhe/ose kufijve të rajoneve të informacionit të fluturimit dhe në veçanti adresimi i aktiviteteve ndërkufitare. Ky bashkëpunim mbulon të gjitha çështjet përkatëse ligjore, operacionale dhe teknike;

d) Shfrytëzimi më së miri i hapësirës ajrore në dispozicion nga njësitë dhe përdoruesit e shërbimeve të trafikut ajror.

Neni 4

Komiteti i Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare

1. Komiteti i Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare (në vijim, Komiteti) është organ konsultativ për veprimet në nivel strategjik dhe vendimmarrës për veprimet në nivel taktik, i krijuar për koordinimin e veprimeve ndërmjet strukturave përgjegjëse civile dhe ushtarake të aviacionit, brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre, me qëllim sigurimin e bashkëpunimit të tyre për përdorimin fleksibël të hapësirës ajrore.

2. Roli i Komitetit është të sigurojë një përdorim të sigurt dhe efikas të strukturës së hapësirës ajrore kombëtare dhe rrjetit të rrugëve të trafikut ajror, si dhe të mundësojë një vazhdimësi e transparencë të trajtimit operacional në kufijtë kombëtarë, bazuar në marrëveshjet e harmonizuara që rrjedhin nga planifikimi i hapësirës ajrore në bashkëpunim me shtetet fqinje.

Neni 5

Përbërja e Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore

Komiteti i Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore ka këtë përbërje:

- a) Drejtori ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil (kryetar);
- b) Komandanti i Forcave Ajrore (nënkryetar);
- c) Përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura (anëtar);
- ç) Përfaqësues i nivelit të lartë drejtues për politikën e transportit ajror, në ministrinë përgjegjëse për transportin (anëtar);
- d) Drejtori i Përgjithshëm i ofruesit të shërbimeve të lundrimit ajror (anëtar);
- dh) Përfaqësues nga përdoruesit e tjerë të hapësirës ajrore (vëzhgues).

Neni 6

Menaxhimi strategjik i hapësirës ajrore (niveli 1)

1. Komiteti për Menaxhimin Strategjik të Hapësirës Ajrore kryen detyrat e mëposhtme:

- a) Garanton aplikimin e plotë të konceptit të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore në një nivel strategjik, parataktik dhe taktik;
- b) Rishikon rregullisht kërkesat e përdoruesve;
- c) Miraton aktivitetet që kërkojnë rezervim apo kufizim të hapësirës ajrore;
- ç) Përcakton strukturat e procedurat e përkohshme të hapësirës ajrore për të ofruar mundësi të shumta për rezervimin e hapësirës ajrore dhe rrugë ajrore;
- d) Përcakton kritere dhe procedura për krijimin e përdorimit të limiteve të përshtatshme horizontale dhe vertikale të hapësirës ajrore të kërkuar, për të rregulluar variantet e ndryshme të korridoreve të fluturimit dhe ndryshimet afatshkurtra të fluturimeve;
- dh) Vlerëson strukturat dhe rrjetin e rrugëve kombëtare të hapësirës ajrore me synim planifikimin për strukturat e procedurat e hapësirës ajrore fleksibël;
- e) Cakton kushtet specifike nën të cilat bie përgjegjësia për ndarjen midis fluturimeve civile dhe ushtarake mbi njësitë e shërbimit të trafikut ajror ose njësitë ushtarake të kontrollit;
- ë) Merr masa për zhvillimin e përdorimit ndërkufitar të hapësirës ajrore me shtetet fqinje, atje ku nevojitet, nga lëvizja e trafikut dhe aktivitetet e përdoruesve;

f) Koordinon politikat kombëtare të menaxhimit të hapësirës ajrore me ato të shteteve fqinje për t'iu adresuar përdorimit të përbashkët të hapësirës ajrore përgjatë kufijve kombëtarë dhe/ose rajoneve kufitare të informacionit të fluturimit dhe këshillon ministrat përgjegjës përkatës;

g) Merr masa për ndërtimin e vënien në dispozicion të përdoruesve të strukturës së hapësirës ajrore në bashkëpunim të ngushtë dhe në koordinim me shtetet fqinje, ku strukturat e hapësirës ajrore në fjalë kanë një ndikim të rëndësishëm mbi trafikun përgjatë kufijve kombëtarë dhe/ose rajoneve kufitare të informacionit të fluturimit, me synimin për të garantuar përdorimin optimal të hapësirës ajrore për të gjithë përdoruesit e saj;

gj) Merr masa për koordinim me shtetet fqinje për vendosjen e një blloku standardesh të përbashkëta për ndarjen midis fluturimeve civile dhe ushtarake për aktivitete ndërkufitare dhe këshillon ministrat përkatës;

h) Vendos mekanizma konsultimi ndërmjet personave ose organizatave, siç referohet te pika 3, e këtij neni, dhe ndërmjet të gjithë partnerëve dhe organizatave përkatëse, për të garantuar që kërkesat e përdoruesve janë adresuar siç duhet;

i) Merr masa për vlerësimin e rishikimin e procedurave dhe të performancës së operacioneve të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore;

j) Ndërton mekanizma për të arkivuar të dhënat mbi kërkesat, shpërndarjen dhe përdorimin aktual të strukturave të saj për analiza të mëtejshme dhe aktivitete planifikimi.

Kushtet referuar shkronjës “e”, të kësaj pike, dokumentohen dhe merren parasysh në vlerësimin e sigurisë në operim, sipas nenit 11, të këtij vendimi.

2. Me angazhimin e autoriteteve civile dhe ushtarake në menaxhimin e hapësirës ajrore, detyrat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, kryhen përmes një procesi të përbashkët civil-ushtarak.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil merr masa për të njoftuar Komisionin Evropian për strukturat të cilat janë përgjegjëse për kryerjen e detyrave të listuara në pikën 1, të këtij neni.

Neni 7

Menaxhimi parataktik i hapësirës ajrore (niveli 2)

1. Një celulë për menaxhimin e hapësirës ajrore krijohet për të qenë përgjegjëse për ndarjen e hapësirës ajrore, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 6, të këtij vendimi.

Me angazhimin e autoriteteve civile dhe ushtarake në menaxhimin e hapësirës ajrore, kjo celulë merr formën e një njësie të përbashkët civile-ushtarake.

2. Dy ose më shumë shtete mund të krijojnë celula të përbashkëta për menaxhimin e hapësirës ajrore.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Komanda e Forcave Ajrore sigurohen që sistemet e përshtatshme mbështetëse vendosen për t'i mundësuar celulës për menaxhimin e hapësirës ajrore që të menaxhojë alokimin e hapësirës ajrore, si dhe për komunikimin në kohën e duhur të disponueshmërisë së hapësirës ajrore të të gjithë përdoruesit e prekur, partnerët dhe organet përkatëse.

Neni 8

Menaxhimi taktik i hapësirës ajrore (niveli 3)

1. Midis njësive përkatëse të shërbimit të trafikut ajror dhe njësive ushtarake të kontrollit duhet të vendosen procedurat e koordinimit civil-ushtarak dhe mënyrat e komunikimit, duke lejuar që të dhënat e ndërsjella për hapësirën ajrore të lejojnë në kohë reale aktivizimin, çaktivizimin ose rindarjen e hapësirës ajrore të caktuar në nivelin parataktik.

2. Njësitë përkatëse të shërbimit të trafikut ajror dhe njësitë ushtarake të kontrollit garantojnë se shkëmbejnë çdo modifikim të aktivizimit të planifikuar të hapësirës ajrore në kohë e në

mënyrë efektive dhe njoftojnë të gjithë përdoruesit e prekur mbi gjendjen aktuale të hapësirës ajrore.

3. Midis njësive të shërbimit të trafikut ajror civil dhe njësive ushtarake të kontrollit ndërtohen procedurat e koordinimit dhe sistemet mbështetëse për të garantuar siguri në operim, kur menaxhohen ndërveprimet midis fluturimeve civile dhe ushtarake.

4. Midis njësive të shërbimit të trafikut ajror civil dhe ushtarak ndërtohen procedura koordinimi për të lejuar transmetimin direkt të informacionit përkatës për të zgjidhur situata specifike trafiku kur kontrollorët civilë dhe ushtarakë ofrojnë shërbime në të njëjtën hapësirë ajrore. Ky informacion përkatës duhet të vihet në dispozicion, në veçanti kur ai kërkohet për arsye sigurie, të kontrollorëve civilë dhe ushtarakë e njësive ushtarake të kontrollit nëpërmjet shkëmbimit në kohë të të dhënave të fluturimit, duke përfshirë pozicionin dhe qëllimin e avionit.

5. Kur zhvillohen aktivitete ndërkufitare, midis njësive të shërbimit të trafikut ajror civil dhe njësive të shërbimit të trafikut ajror ushtarak dhe/ose njësive ushtarake të kontrollit pjesëmarrëse në këto aktivitete, duhet të hartohen procedurat e përbashkëta për të menaxhuar situatat specifike të trafikut në hapësirat ajrore përkatëse.

Neni 9

Përgjegjësitë e Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore si celula kombëtare e krizave për menaxhimin e trafikut ajror

1. Komiteti vepron si celula kombëtare e krizave për menaxhimin e trafikut ajror për situatat e krizave kombëtare ose ndërkombëtare, që implikojnë hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë.

2. Në këtë kuadër, Komiteti merr masat e mëposhtme:

a) Me marrjen e indikacioneve, edhe në vijim të komunikimeve me NATO-n, se një situatë krize e mundshme është afër, organizon mbledhje koordinuese civile–ushtarake për menaxhimin e trafikut ajror, me qëllim ndërgjegjësimin mbi implikimet e hapësirës ajrore në situatën në fjalë, strukturën përkatëse dhe menaxhimin e saj;

b) Me deklarimin e masave parandaluese kombëtare, edhe në vijim të komunikimeve të NATO-s, ndaj një niveli në rritje të situatës së krizës, përgatitet për aktivizimin e celulës së krizave për menaxhimin e trafikut ajror, harton procedurat e punës për palët e përfshira dhe bën komunikimin përkatës për kohën e aktivizimit, palët në proces dhe procedurat;

c) Për operimet që duhet të kryhen gjatë gjendjes së krizës:

i. përcaktohet struktura e hapësirës ajrore;

ii. kryhen mbledhje koordinuese me përdoruesit e hapësirës ajrore;

iii. monitorohet konfigurimi i përdorimit të hapësirës si nga civilët, edhe nga ushtarakët;

iv. koordinon trafikun joluftarak, kur është e zbatueshme, brenda dhe jashtë zonës së operimit (ASC);

v. përdoren pikat e kontaktit për të miratuar e koordinuar fluturimet civile, shtetërore dhe humanitare, të cilat nuk janë në përputhje me procedurat e miratuara;

ç) Me kalimin e situatës së krizës, zhvillohen takime koordinuese për normalizimin e situatës.

Neni 10

Gjendja e jashtëzakonshme dhe e luftës

Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe/ose të luftës, Komiteti nuk vepron më si celula kombëtare e krizave për menaxhimin e trafikut ajror dhe Komanda e Forcave Ajrore merr përgjegjësitë për kontrollin e shërbimeve të trafikut ajror, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Vlerësimi i sigurisë në operim

Komiteti, për të ruajtur ose rritur nivelet ekzistuese të sigurisë në operim, duhet të garantojë që, brenda kontekstit të një procesi menaxhimi të sigurisë, kryhet një vlerësim i sigurisë, duke përfshirë identifikimin e rreziqeve, vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut, përpara se kërkesat për përdorimin fleksibël të hapësirës ajrore të vihen në zbatim.

Neni 12
Raportimi

Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të japë të gjitha elementet e detajuara në aneksin që i bashkëlidhet këtij vendimi, në funksion të raportimit vjetor në Komisionin Evropian për zbatimin e përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore, kur është e zbatueshme, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe.

Neni 13
Monitorimi i përputhshmërisë

Autoriteti i Aviacionit Civil, me anë të inspektimeve dhe auditimeve të sigurisë në operim, monitoron zbatimin e këtyre rregullave.

Neni 14
Shfuqizime

Ngarkohen ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Mbrojtjes për marrjen e masave për shfuqizimin e urdhrave të përbashkët të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministrit të Mbrojtjes nr. 866, datë 13.12.2018, “Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare”, dhe nr. 867, datë 13.12.2018, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta për përdorimin fleksibël të hapësirës ajrore’”.

Neni 15
Institucionet që ngarkohen

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS

**LISTA E ELEMENTEVE TË KËRKUARA PËR RAPORTIMIN VJETOR
MBI APLIKIMIN E PËRDORIMIT FLEKSIBËL TË HAPËSIRËS AJRORE**

a) Përshkrim i përgjithshëm i organizimit kombëtar dhe përgjegjësitë në nivelet 1, 2 dhe 3, të konceptit të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore;

b) Vlerësimi i funksionimit të marrëveshjeve, procedurave dhe sistemeve mbështetëse të ndërtuara në nivele strategjike, parataktike dhe taktike të menaxhimit të hapësirës ajrore. Ky vlerësim duhet të kryhet në lidhje me parrezikshmërinë, kapacitetin e hapësirës ajrore, eficiencën dhe fleksibilitetin e operacioneve të avionit për të gjithë përdoruesit;

c) Problemet e ndeshura gjatë zbatimit të këtij projektvendimi, veprimet e ndërmarra dhe nevoja për ndryshime;

ç) Rezultati i inspektimeve kombëtare, survejimeve dhe auditimeve të parrezikshmërisë;

d) Bashkëpunimi i shteteve anëtare të ZPEA-së nëpërmjet autoriteteve përkatëse mbi menaxhimin e hapësirës ajrore dhe, veçanërisht, mbi krijimin e menaxhimin e hapësirave ajrore ndërkufitare dhe aktiviteteve ndërkufitare.